



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA - SUPREME COURT OF KOSOVO

- Për: Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK)
 - Nga: Dhoma e Posaqme e Gjykatës Supreme e Republikës së Kosovës (DHPGJS)
-
- Datë: 04 prill 2024
 - Lënda: RAPORT NARRATIV PËR PUNËN E DHOMËS SË POSAQÇME TË GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR PERIUDHËN
01 janar – 31 mars 2024

Në DHPGJS gjatë tremujorit të parë kanë qenë të angazhuar **14** gjyqtarë në zgjidhjen e lëndëve, **11** prej tyre në shkallën e parë dhe **3** në shkallën e dytë gjegjësisht në Kolegjin e Apelit. Gjatë tremujorit gjyqtarët janë përkrahur nga **6** bashkëpunëtorë profesional, si dhe me nga një zyrtar ligjor.

Lëndët në punë gjatë tremujorit


Gjithsej në dy shkallët gjyqësore në fillim të tremujorit të parë të viti janë trashëguar nga tremujori paraprak **13295** lëndë, janë pranuar edhe **375** lëndë të reja, kështu gjatë tremujorit në punë kanë qenë **13670** lëndë. Prej tyre janë zgjidhur **854** lëndë, kurse kanë mbetur të pazgjidhura gjithsej **12816** lëndë në dy shkallët gjyqësore.

Në shkallën e parë gjyqësore nga **12453** lëndë sa kanë qenë në punë, janë zgjidhur **627** lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa zgjidhura **11826** lëndë në fund të tremujorit.

Në shkallën e dytë gjyqësore nga **1217** lëndë sa kanë qenë në punë janë zgjidhur **227** lëndë, ndërsa kanë mbetur të pa zgjidhura **990** lëndë në fund të tremujorit.


Në tabelën më poshtë janë paraqitur gjitha lëndët e trashëguara (paraprake) në fillim të tremujorit, lëndët e reja të pranuara, lëndët në punë, lëndët e kryera dhe lëndët e mbeturat e pakryera në fund të tremujorit.

TM I



Efikasiteti i zgjidhjes së lëndëve në raport me lëndët e reja të pranuara gjatë tremujorit

Shkalla e efikasitet të lëndëve të kryera në raport me lëndët e reja të pranuara gjatë tremujorit është **227.73%**, ngase janë kryer 854 lëndë, ndërsa janë pranuar 375 lëndë të reja.



Krahasimi me tremujorin paraprak

Krahasuar me tremujorin paraprak (tetor – dhjetor 2023) kemi një rënje të lehtë të numrit të lëndëve të kryera ngase janë kryer 42 lëndë më pakë se në tremujorin paraprak. Në tremujorin paraprak janë kryer 896 lëndë kurse në këtë tremujorin janë kryer 854 lëndë.

Faktoret që kanë ndikuar në numrin e lëndëve të kryera janë:

Në këtë tremujor gjatë muajit janar kemi patër një gjyqtar më pak krahasuar me tremujorin paraprak, një gjyqtarështë avancuar nga shkalla e parë në Kolegin e shkallës së dytë, nga muaji shkurt kanë filluar punën dy gjyqtarë të ri. Gjyqtarët e ri dhe gjyqtari i avancuar kanë patër nevojë që të adaptohen me punën në gjykatë kështu që kjo u ka marrë kohë. Gjyqtarët e shkallës së parë shpesh herë kanë qenë të angazhuar si anëtarë të kolegjeve në seanca gjyqësore e ky angazhim ka ndikuar në punën e tyre rrëth lëndëve të veta. Gjithashtu gjatë këtij tremujori, gjegjësisht nga fillimi i muajit mars kemi patër më pak një bashkëpunëtor profesional dhe tri zyrtare ligjore.


Sa i përket efikasitetit në këtë tremujor, kemi rritje të efikasitetit në zgjidhjen e lëndëve në reportin lëndët e kryera dhe lëndët e reja të pranuara gjatë tremujorit. Në tremujorin paraprak shkalla e

efikasitetit ka qenë 129.67% kurse në këtë tremujor është 227.73%. Kjo rritje është si rezultat i numrit më të ultë të lëndëve të reja të pranuara në këtë tremujor krahasuar me tremujorin paraprak. Në tremujorin paraprak janë pranuar 691 lëndë të reja kurse në këtë tremujor janë pranuar 375 lëndë të reja.

Lëndët e zgjidhura sipas natyrës ligjore gjatë tremujorit

Në tabelën më poshtë, janë listuar lëndët e zgjidhura gjatë tremujorit të katërt, që përfshijnë:


215 lëndë - AC - I, Ankesat kundër vendimeve të shkallës së I-rë të Dhomës së Posaçme,
 12 lëndë - AC - II, Ankesat kundër vendimeve të gjykatave të rregullta,
 2 lëndë - C - I, Paditë e Privatizimit dhe të Ndryshme,
 19 lëndë - C - II, Paditë nga Mardhënja e punës, dhe Listat e punëtorëve për 20%,
 46 lëndë - C - III dhe SCC, Paditë Pronësore,
 560 lëndë - C - IV dhe SCL, Paditë e Likuidimit.



Publikimi i vendimeve gjatë tremujorit

Gjatë tremujorit të katërt është vazhduar me publikimin e vendimeve të Gjykatës, kështu që janë publikuar në Web faqe, gjithsej 382 vendime të Dhomës së Posaçme. Prej tyre 301 vendime janë të shkallës së parë gjyqësore, kurse 16 vendime janë të shkallës së dytë.

Publikimi i vendimeve
(382 vendime të publikuara)



Regjistrimi i lëndëve në SMIL

Gjatë këtij tremujori është vazhduar me regjistrimin e lëndëve të reja të ardhura gjatë tremujorit në sistemin SMIL.

Ka probleme me nxjerrjen e raporteve në SMIL, sistemi nuk po i gjeneron si lëndë të regjistruara lëndët nga Mardhënja e punës (C-II) dhe lëndët e Kolegit të Apelit (AC-I). Kurse Lëndët e Kolegit të Apelit të transferuara nga gjykatat e rregullta (AC-II) nuk po mund të registrohen në SMIL sepse nuk po i pranon sistemi. Ndarja e lëndëve të reja në punë te gjyqtarët ende është duke u bërë me short pasi që SMIL-i ende nuk po na mundeson ndarjen automatike.

Seancat gjyqësore publike

Gjatë tremujorit të katërt, kolegjet gjyqësore i kanë caktuar dhe i kanë mbajtur 102 seanca gjyqësore publike.

Identifikimi i problemeve dhe propozimi për zgjidhjen e tyre

Lidhur me problemet, sfidat dhe vështirësitet që i ka DHPGJS-ja, tashmë është reportuar në KGJK, gjatë raportimit të punës së DHPGJS-së për tre mësuesit paraprak. DHPGJS-ja vazhdimisht është duke u përballur me numër të pamjaftueshëm të gjyqtarëve. Kështu në bazë të ngarkesës që e ka me lëndë, nevojat reale për gjyqtar, në të dy shkallët është ti ketë 20 gjyqtarë.

Gjithashtu dua ta paraqesë nevojën që sa më shpejtë që të jetë e mundur të plotësohen **pozitat e lira** në DHPGJS siç janë: **tre** bashkëpunëtorë profesional (njëra pozitë është e lirë nga muaji korrik vitit 2023 kur një bashkëpunëtor është transferuar në Gjykatën Themelore në Ferizaj, pozita e dytë është liruar në muajin nëntor të vitit 2023 kur një bashkëpunëtor ka shkua në pension dhe pozita e tretë është liruar në muajin mars 2024 kur një bashkëpunëtor është dorëhequr), një udhëheqës i Zyrës për Mbështetje Juridike, të plotësohet pozita e lirë e një përkthyesi, një dorëzuesi dhe një zyrtari ligjor e cila është liruar në muajin nëntor 2023 pas dorëheqjes së një zyrtari ligjor.

Lidhur me problemin e përkthimit gjithashtu kam reportuar edhe në tremujorët paraprak. Krahas plotësimit të shpejtë të pozitës së lirë të përkthyesit, duhet gjykatës ti lejohet edhe një pozitë tjeter e re. Aktualisht lëndët e dërguara për përkthim në Njësinë e përkthimeve, mbesin 2-3 muaj deri sa të përkthehen, nga se janë grumbulluar dokumentet dhe vendimet që duhet të përkthehen. Njësia e përkthimeve, nëse do ti kishte 4 përkthyes, do të shkurtohej ndjeshëm koha e pritjes për përkthimin e dokumenteve.

Një tjetër problem është edhe hapësira e pa mjaftuar e punës. Rritja e numrit të gjyqtarëve, por edhe plotësimi i pozitave të lira për stafin e gjykatës, imponon nevojën e sigurimit të hapësirës së re për punë. Kjo do të jetë një sfidë e re, kur dihet ngarkesa që është sot në Pallatin e Drejtësisë.